

Programi i mediave

A dëshiron një bazë të mirë për punësim në një lëmi të popullarizuar dhe të larmishëm?

A dëshiron të vazhdosh studimet pas gjimnazit?

A dëshiron të mësosh se si të analizosh reklamat dhe lajmet?

A dëshiron të provosh të punosh që nga gjimnazi?

A dëshiron të punosh dhe të studiosh jashtë vendit në ardhmëri?

Në atë rast, Programi i mediave mund të jetë për ty.

Te Programi i mediave do të mësosh të krijosh dhe të ndërmjetësosh informacione. Do të ushtrosh poashtu edhe se si të interpretosh dhe të analizosh për shembull reklamat.

Kualifikimi te Programi i mediave është edhe teorik por edhe praktik. Shpesh herë do të jepet mundësia të provosh të punosh vetë dhe në mënyre të pavarur.

Të shumtë janë ata që duan të punojnë në lëminë e mediave. Për këtë arsye mund të jetë e vështirë të punësoshesh menjëherë pas gjimnazit. Por koha yte te Programi i mediave mund të të ndihmojë që të kuptosh se çfarë lloj pune do të kishe dashur të keshë. Më pas, ti mund të vazhdosh studimet që të arrijshë aty ku dëshiron.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Ekzistojnë shumë lloje punësh që mund t'i kërkosht pasi që të përfundosh te Programi i mediave, siç është për shembull lëmia e shtypshkronjave. Në të shumtën e rasteve do të duhet që të vazhdosh studimet që të keshë një mundësi të pranohesh në një punë mediash. Ka shumë kualifikime te kjo lëmi. Mundesh për shembull të zgjedhësh që të studiosh te Fakulteti i profesioneve ose te Shkolla e lartë popullore, universitet apo fakultet. Ka kualifikime me drejtim teknik dhe drejtim kreativ.

Në disa raste ndoshta do të duhet që të kompletosh shkollimin tënd gjimnazial. Bisedo me udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Punë ku mund të pranohesh

Shembuj për punë mediash janë gazetarë, fotograf, formues grafik, shkrimtar tekstesh, redigjues, drejtues arti, informator dhe producent. Për shumicën e këtyre punëve kërkohet që të vazhdosh studimet pas gjimnazit.

Përmbajtja e Programit

Programi i mediave përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programmin e mediave. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej dy drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin e mediave në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimit. Në disa vende mund të ketë edhe më tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve!

Drejtimet kombëtare janë:

- Prodhim mediatik – për ty që dëshiron të mësosh mbi teknika të ndryshme mediatike, për shembull shfaqje dhe ekspozitë, komunikacion grafik, radio dhe media tjera të zërit, pikturë fotografike, film dhe televizor, gjithashtu edhe informacion i dhënë përmes tekstit
- Teknik e shtypit – për ty që dëshiron të mësosh të bësh botime me ndihmë të teknikave të ndryshme grafike.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi i mediave do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me kompani të ndryshme dhe vende të lira të punës aty ku banon ti. Vendi i punës ku do të pranohesh ka gjithashtu të bëjë edhe me drejtimin që e zgjedh. APU është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Mund të jetë e vështirë të punësohesh te lëmia e mediave, edhe sikur të vazhdosh studimet pas gjimnazit. Shumë njëjërëz i kërkojnë ato vende punë që janë të lira dhe shumë të tjerë me kualifikim mediatik janë të papunë.